

## AKT THEMELIMI

Ne Elbasan, sot me date 13.10.2021 (dymije e njezete e nje), personat e meposhte permendur ne cilesine e "Ortakeve Themelues":

Endri Rula I biri I Thanas i datelindjes 14/03/1982, lindur ne Elbasan dhe banuese ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar, I identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit ID Nr 032674110 .

Illir Rula I biri I Thanas i datelindjes 29/11/1985, lindur ne Elbasan dhe Banuese ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar , I identifikuar sipas ligjit nepermjet ID Nr 034049701

Deklarojne me vullnetin e tyre te plote e te sinqert dhe me iniciativen e tyre te lire e private mbeshetur ne kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne Ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", ne ligjin per "QKR" ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, te krijojne shoqerine tregetare me pergjegjesi te kufizuar me emertim "RULA" SH.P.K

### KREU 1

#### Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

##### Neni 1

##### Emertimi

Emertimi I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte RULA SH.P.K

##### Neni 2

##### Forma Juridike

Shoqeria RULA SH.P.K eshte person juridik I te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria") e themeluar nga personat fizik te siperpermendur te cilet nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me kushtet e procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria pasi te kete fituar personalitetin juridik eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjat veprimtarise se saj

##### Neni 3

##### Selia



Shoqeria e ka seline ne Adresen: RRuga Vasil Tarja pall 499 nr pasurie5/384-N.1

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filial, si Brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetem me vendim te Asamblese se Ortakëve te Shoqërisë.

#### **Neni 4**

#### **Objekti**

Invesime , Mnxhim projektësh , Shitje blerje Etj.

#### **Neni 5**

#### **Kohezgjatja**

Shoqeria do zhvilloj aktiviteti e saj per nje perjudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR

### **KREU II**

### **KAPITALI**

#### **Neni 6**

#### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar I shoqërisë është 100.000 leke dhe është I perbere nga 2 kuota.

Kapitali I mesiperm është nenshkruar nga ortakët e shoqërisë:

Endri Rula, zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 50.000 Leke, qe perbejne 50% te kapitalit themeltar te shoqërisë

Ilir Rula, zoterues i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 50.000 Leke, qe perbejne 50% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

#### **Neni 7**

#### **Transferimi I Kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

a) Kontributit ne kapitalin e shoqërisë



b) Shitblerjes

c) Trashegimise

d) Dhurimit

dh) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

##### Neni 8

##### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi I vetem vendimmarres I shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi I vetem vendimmarres I shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve te shoqerise eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin e shkrarkimin e administratoreve
- d) Emerimin e shkrarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te miratuar
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike
- f) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) Perfaqesimi e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- l) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute

Ortaket mund te perfaqesohen ne asamblene e pergjithshme ne baze ten je autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person I trete

Administratori I shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues I ortakeve ne asamblene e pergjithshme



Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite

#### **Neni 9**

##### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme per ndryshimet e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, vendoset me miratimin dhe me votat e ortakeve zoterues te kapitalit te shoqerise, qe jane pjesemarres ne mbledhje

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave, per ceshtje te tjera si :

- a) Percaktimi e politikave tregtare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkiminn e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te miratuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykata dhe ne procedimet e tjera nda j administratoreve
- g) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pran QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise

#### **Neni 10**

##### **Administrimi**

(1) Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratorë te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertitjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e nje shoqerie tregtare memë, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratorë te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqerisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:



- Endri Rula
- Ilir Rula

- Me kompetenca te pakufizuara
- Me kompetenca te pakufizuara

## Neni 11

### Kompetencat

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Kreu 12**

### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërise në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## **Neni 13**

### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohe zgjatja e parashikura në themelimin e tij
- b) Me vendim të asamblese së përgjithshme
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar përzullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- e) Me vendim të gjykatës

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuiditorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuiditorit dhe emertesen shtese "Shoqëri në likuidim e sipër"

## **Neni 14**

### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodin Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 15**



## Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statute, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente ne Gjykata Shqiptare.

### ORTAKET E SHOQERISE

ENDRI RULA



ILIR RULA

